



PARTIA SHQIPTARE DEMOKRISTIANE E KOSOVËS

Raportet financiare të fushatës dhe Raporti i Auditorëve të pavarur

Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës
16 Shtator 2021 deri me 15 Tetor 2021

Përmbajtja:

Raport i auditorëve të Pavarur..	3
Pasqyra e Pozitës Financiare.....	6
Pasqyra e te Hyrave dhe Shpenzimeve.....	7
Informata të përgjithshme	8
Shënimet e pasqyrave financiare.....	9- 13

Raport i Auditorëve te pavarur

Drejtuar Kryesisë së PARTIA SHQIPTARE DEMOKRISTIANE E KOSOVËS

Raport mbi Pasqyrat Financiare për qëllime specifike

Mohim i Opinionit

Ne kemi qenë të angazhuar për të audituar raportet financiare të fushatës për zgjedhjet lokale të bashkëngjitura të Subjektit Politik “PARTIA SHQIPTARE DEMOKRISTIANE E KOSOVËS” (në vijim referuar si “Subjekti Politik” apo “PSHDK”), të përbëra nga Pasqyra e Pozitës Financiare me 15 Tetor 2021, Pasqyra e të Hyrave dhe Shpenzimeve për periudhën 16 Shtator 2021 deri me 15 Tetor 2021, dhe informacionin tjetër shpjegues të përfshira në faqe 6-13.

Ne nuk shprehim një opinion mbi raportet financiare të fushatës të subjektit PARTIA SHQIPTARE DEMOKRISTIANE E KOSOVËS. Për shkak të rëndësisë së çështjeve të përshkruara në paragrafin bazat për mohim të dhënies së opinionit, ne nuk kemi qenë në gjendje të sigurojmë evidencën e nevojshme të auditimit për të fituar një bazë për një opinion të auditimit.

Bazat për mohim të opinionit

- Ashtu siç është shpalosur në shënimin Shënimi 3: Donacionet dhe kontributet në të holla, Subjekti Politik ka pranuar donacione në total vlerën prej 4,690.00 euro. Në mungesë të dokumentacionit mbështetës de listës detale të donacioneve të pranuar, ne nuk kemi mundur të përcaktojmë nëse të hyrat e pranuar janë në pajtim me kërkesat e përcaktuara me Ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 3, i cili kërkon që të hyrat nga donacionet të realizohen përmes transaksioneve bankare dhe të jenë në vlerë jo më të madhe se 2000.00 Euro nga një person fizik brenda vitit.
- Po ashtu, Subjekti Politik, në (Shënimi 2) ka prezantuar shpenzimet sipas kategorive por nuk i ka paraqitur pagesat e atyre shpenzimeve. Në mungesë të prezantimit të pagesave, SP ka rezultuar të ketë detyrime në fund të vitit e të cilat nuk janë prezantuar në Pasqyrën e Pozitës Financiare duke nën dekluarur kështu detyrimet në datën e raportimit.
- SP PSHDK nuk ka regjistrime në librin e arkës të transaksioneve të kryera, si për të hyrat në para të gatshme në vlerë prej 2,600.00 euro ashtu edhe për blerjet ose furnizimet me para të gatshme. Pa këto informata dhe transaksione të arkës që nuk janë të regjistruara dhe të klasifikuara sipas kategorive të shpenzimeve të raportuara ashtu siç kërkohet me ligjin për financimin e subjekteve politike, ne e kishim të pamundur të verifikojmë me saktësi nëse transaksionet e raportuara janë të sakta dhe valide, të regjistruara drejt dhe se i takojnë aktivitetit të vet SP PSHDK.

Theksim i çështjes

- Ne po ashtu tërheqim vëmendjen në lidhje me gjetjet e mëposhtme:

- Subjekti Politik nuk ka mirëmbajtur një kontabilitet të mirëfilltë për ti mundësuar regjistrimin e transaksioneve financiare dhe përgatitjen e pasqyrave financiare sipas standardeve të kontabilitetit të aplikueshme në Kosovë. Në mungese të librave kontabël dhe shënimeve të mirëfillta ne e kishim të pamundur aplikimin e procedurave të auditimit ashtu siç kërkohet me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit.
- Subjekti Politik nuk e ka të definuar me Statut, mundësinë e ushtrimit të kontrollit të brendshëm financiar të saj dhe të drejtën e anëtarëve për t'u informuar për të gjitha të hyrat dhe shpenzimet e subjekteve politike si dhe për përgjegjësinë e organit gjegjës për transaksione financiare, ashtu siç parashihet në ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 17 Kontrolli i Brendshëm.
- Subjekti Politik nuk ka respektuar kërkesat ligjore në lidhje me publikimin e raporteve financiare vjetore dhe të fushatës sipas ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar, paragrafi 5.1 dhe 5.2.
- Subjekti Politik nuk ka llogari bankare aktive për të realizuar transaksionet financiare.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe e atyre të ngarkuar me qeverisje për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058 dhe për ato kontrole të brendshme që menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së subjektit politik për të vazhduar aktivitetin e saj (parimi i vijimësisë), shpalosjen, sipas rastit, të çështjeve që lidhen me parimin e vijimësisë dhe përdorimin bazës së kontabilitetit sipas parimit të vijimësisë përveç nëse menaxhmenti synon të likuidojë Subjektin Politik ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë realiste përveç për ta bërë këtë.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të kompanisë.

Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi, dhe për të nxjerrë raportin e një auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticismin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionin mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Audit & Conto sh.p.k

Besa Sahitaj Berisha
Auditore Ligjore
18 Tetor 2023

Pasqyra e Pozitës Financiare

Pasuritë		Gjendja në fund të periudhës	Gjendja në fillim të periudhës
Pasuritë afatgjata	Shënimi	Shuma në Euro	Shuma në Euro
Toka, objektet dhe pajisjet	5		
Pasuritë e paprekshme			
Pasuritë tjera afatgjata			
Total pasuritë afatgjata		0.00	0.00
Pasuritë afatshkurtra		0.00	0.00
Llogaritë e arkëtueshme			
Parapagimet			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	3		
Pasuritë tjera afatshkurtra			
Total pasuritë afatshkurtra		0.00	0.00
Total pasuritë			
Ekuiteti			
Fondet e akumuluar			
Suficiti / (deficiti) i vitit			
Total Ekuiteti		0.00	0.00
Detyrimet			
Detyrimet afatgjata			
Huatë e pagueshme			
Të hyrat e shtyera	5		
Gjithsej detyrimet afatgjata		0.00	0.00
Detyrimet afatshkurtra		0.00	0.00
Llogaritë e pagueshme dhe të tjera	8		
Huatë e pagueshme			
Detyrimet tjera afatshkurtra	9		
Gjithsej detyrimet afatshkurtra		0.00	0.00
Gjithsej detyrimet		0.00	0.00
Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet		0.00	0.00

**Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve
 Pasqyrat Financiare**

	Shënimi	Vlera në euro
Të hyrat		
Të hyrat nga buxheti		
Të hyrat nga anëtarësia		
Donacionet dhe kontributet në të holla	3	2,090.00
Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime	4	
Të hyrat e fushatës		
Te hyrat e liruara nga te hyrat e shtyera	5	
Të hyrat tjera		2,900.00
Gjithsej të hyrat për vitin		4,990.00
Shpenzimet		
Pagat dhe kompenzimet	2	0.00
Shpenzimet e transportit	2	250.00
Reklamat, reprezentacioni dhe konferencat	2	550.00
Blerja e mallrave	2	125.00
Shpenzimet e përgjithshme	2	1,975.00
Shpenzimet e ndryshme	2	2,090.00
Gjithsej shpenzimet për vitin	2	4,990.00
Suficiti / (deficiti) për vitin		0.00

1. Informata të përgjithshme

Emri i plotë i SP është PARTIA SHQIPTARE DEMOKRISTIANE E KOSOVËES me seli në Adresën: rr.Rrustem Statovci, Prishtinë.

Kryetari i SP PSHDK për vitin 2021 është : z. Zef Morina
Zyrtar financiar : Sarë Gjergji

Pasqyrat financiare te subjektit politik janë përgatitur sipas kërkesave te Ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar.

Bazuar në nenin 19 paragrafi 2 pika 7 e Ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058 „Subjekti i regjistruar politik brenda pesë (5) ditëve të punës nga marrja e draft raporteve të audituara ka dorëzuar raportin e rishikuar financiar dhe shpjegimet lidhur me gabimet ose lëshimet të identifikuara nga auditorët.

Subjekti Politik nuk ka llogari bankare aktive ne bankat komerciale ne vende.

Shënimi 2. Shpenzimet

Shpenzimet	Shpenzimi në Euro	Pagesa në Euro	Borxhi i mbetur në Euro
Pagat dhe kompensimet			
Pagat dhe kompensimet, neto			
Vëzhguesit dhe komisionerët			
Kontributet pensionale të punëdhënësit			
Kontributet pensionale të punëdhënësit			
Tatimet në paga			
Gjithsej	0.00	0.00	0.00
Shpenzimet e transportit			
Automjetet motorike të huazuara	250.00	0.00	250.00
Karburantet			
Biletat, aeroplanit/autobusit/trenit/taksit etj.			
Sigurimi dhe mirëmbajtja e veturave			
Çdo shpenzim tjetër i transportit			
Gjithsej shpenzimet e transportit	250.00	0.00	250.00
Reklammat, reprezentacioni dhe konferencat			
Lokali			
Ushqimi			
Aktivitete kulturore dhe rekreative			
Radio dhe spotet televizive			
Stendat e afishmit dhe reklamimet në gazeta	550.00	0.00	550.00
Shpenzimet tjera të reklamave, reprezentacionit dhe konferencave			
Gjithsej reklammat, reprezentacioni dhe konferencat	550.00	0.00	550.00
Blerja e mallrave			
Furnizimi i zyrës			
Pajisjet të vogla			
Gjithsej blerja e mallrave	0.00	0.00	0.00

PARTIA SHQIPTARE DEMOKRISTIANE E KOSOVËS
Pasqyrat Financiare 16 Shtator 2021 deri me 15 Tetor 2021

Shpenzimet e përgjithshme			
Qiraja e lokalit të zyrës			
Telefoni, interneti dhe posta	75.00		75.00
Rryma, shërbimet komunale (uji dhe mbeturinat)	45.00		45.00
Shpenzimet e zhvlerësimit të pasurisë afatgjatë			
Shpenzimet lidhur me donacionet dhe kontributet në natyrë në mallra dhe shërbime	2,090.00		2,090.00
Gjithsej shpenzimet e përgjithshme	2,210.00		2,210.00
Shpenzimet e ndryshme			
Mirëmbajtja e pajisjeve dhe hapësirave të zyrës			
Shpenzimet që nuk janë përfshirë në asnjë kategori tjetër	1,980.00		1,980.00
Gjithsej shpenzimet e ndryshme	1,980.00		1,980.00
Gjithsej shpenzimet	4,990.00		4,990.00

Shënimi 3: Donacionet dhe kontributet në të holla

Pranuar nga			Data kur është dhënë kontributi	Vlera në euro	E pranuar përmes:	
Kontribuesi	Adresa	Numri personal			Bankë	Arkë
Gjithsej donacionet dhe kontributet në të holla				4,690.00	2,090.00	2,600.00

Shënimi 4: Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime

Përshkrimi i mallit / shërbimit	Pranuar nga			Data kur është dhënë kontributi	Vlera në euro
	Kontribuesi	Adresa	Numri personal		
Vetura personale	Agim Syla	Peje		20.09.2021	300.00
Gjithsej kontributet në natyrë në mall dhe shërbime					300.00

Shënimi 5: Toka, objektet dhe pajisjet

	Bilanci në fillim të vitit (kosto historike)	Blerjet gjatë vitit	Zhvlerësimi i akumuluar	Zhvlerësimi i vitit	Bilanci në fund të vitit (vlera neto)
Toka					
Objektet					
Veturat					
Pajisjet e zyrës					
Pajisjet e teknologjisë informative					
Pajisjet tjera					
Gjithsej toka, objektet dhe pajisjet					

Shenime tjera

Shënimi 6. Llogari të arkëtueshme	Gjendja në fund të periudhës Shuma në Euro	Gjendja në fillim të periudhës Shuma në Euro
Gjithsej Llogarit e arkëtueshme		

Shënimi 7. Paraja dhe ekuivalentët e parasë	Gjendja në fund të periudhës Shuma në Euro	Gjendja në fillim të periudhës Shuma në Euro
Paraja në bankë		
Paraja në arkë		
Gjithsej paraja dhe ekuivalentët e parasë		

Shënimi 8. Llogaritë e pagueshme dhe të tjera	Gjendja në fund të periudhës Shuma në Euro	Gjendja në fillim të periudhës Shuma në Euro
Furnitori 1 - regjistri		
Furnitori 1		
Gjithsej llogaritë e pagueshme dhe të tjera		

Shënimi 9. Detyrimet tjera afatshkurtra	Gjendja në fund të periudhës Shuma në Euro	Gjendja në fillim të periudhës Shuma në Euro
Detyrimet për paga dhe tatime		
Detyrimet për qira		
Detyrimet për gjoba dhe ndëshkime		
Detyrime tjera afatshkurtër (huazimet)		
Gjithsej detyrimet tjera afatshkurtra		

